



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.98/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada - Glllogjani anëtarë, me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR dega në Pejë, për shkak të vendosjes së posterit në vende publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, dhe koalicionit LDK-AKR dega në Pejë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,100.00 (dymijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 06.06.2017, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017, rreth orës 21:00 në rrugën “Adem Jashari”, pra nga qendra në Pejë, aktivistja Arta Berisha ka vërejtur një poster të kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Xhevdet Krasniqi nga radhët e koalicionit LDK-AKR i vendosur nëpër drunjë, pra në hapsirë publik Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b i Rregullës Zgjedhore të KQZ-së nr.11/2013, neni 3.4 i Rregullës Zgjedhore nr.13/2014, vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë publike përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre . Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë i datës 07.06.2017 koalicioni LDK-AKR, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se kemi vepruar konform dispozitave të nenit 120 paragrafi 1 pika a) i LZP-së, duke udhëruar kandidatin që të ndërmarrë veprime përmirësuese, nga të cilat veprime është evituar shkelja e pretenduar sipas ankesës. Koalicioni LDK-AKR e ka vendosur posterin e kandidatit për deputet dhe se koalicioni LDK-AKR pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së kanë ndërmarr masat përmirësuese, për evitim të shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur një foto nga vendi ku është larguar posterit

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoj shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 i LZP-së, gjeti se :

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se, posteri i kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Xhevdet Krasniqi nga radhët e koalicionit LDK-AKR dega në Pejë, është vendosur në pemë në rrugën “Adem Jashari”, në qendër të Pejës, pra në hapsira publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) i LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e theksuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga koalicioni LDK-AKR, është vendosur në një pemë, pra në hapsirë publike. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë koalicioni LDK-AKR, në përgjigjen në ankesë i datës 07.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni LDK-AKR kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftu me rregullat zgjedhore, se shkelja nga ana e tyre është përsëritur vazhdimisht gjatë këtij procesi zgjedhor dhe për kundër këtij fakti posteri i kandidatit për deputet nga ky koalicion është i kapur me ngjic në pemë pra në hapsira publike . Po ashtu si rrethanë , PZAP-i e morri edhe faktin që koalicionit në fjalë ia dha mundësin për tu përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.98/2017 më datën 07.06.2017.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.